

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 Për Fondet Pensionale në Kosovë me ndryshim plotësimet e mëtutjeshme të këtij Ligji. FKPK-ja, në përputhje me nenin 8 dhe 16 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 shpall:

## KONKURS PËR PUNË PRAKTIKE

Për plotësimin e pozitës me të dhënat si në vijim:

<b>Titulli i pozitës:</b>	<b>PRAKTIKANTË NË NJËSINË E SHËRBIMIT PËR KLIENTË</b>
<b>Orët e punës:</b>	40 orë në javë
<b>Numri i referencës:</b>	<b>KON042026</b>
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	6 (gjashtë) muaj me mundësi vazhdimi në 1 (një) vit
<b>Adresa:</b>	Rr. "Perandori Justinian" Nr. 71, 10000 Prishtinë

### DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

- Pranimi dhe koordinimi i thirrjeve telefonike.
- Pritja e vizitorëve në zyrë dhe orientimi i tyre te këshilltarët tjerë për klientë.
- Asistimi në identifikimin, vlerësimin dhe zgjidhjen e kërkesave të klientëve.
- Sigurimi i një sjelljeje profesionale dhe të sjellshme ndaj klientëve të FKPK-së.
- Përdorimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të zyrës, si kompjuteri, telefoni, fotokopjuesi dhe skaneri.
- Administrimi i dokumenteve dhe dërgesave, përfshirë protokollimin, arkivimin, radhitjen dhe shpërndarjen e tyre.
- Menaxhimi i inventarit të zyrës, duke përfshirë mbajtjen e shënimeve dhe realizimin e kërkesave për furnizim.
- Respektimi i orarit të punës me përpikëri.

### KRITERET E KONKURSIT:

<b>Përvoja:</b>	Nuk aplikohet
<b>Edukimi:</b>	Diplomë universitare (së paku baçelor të fituar nga viti 2023 e tutje) (ose studentët e vitit të fundit të studimeve)
<b>Nota mesatare:</b>	Së paku 7.5
<b>Gjuha:</b>	Njohuri e shkëlqyer e gjuhës shqipe Njohuria e gjuhëve serbe dhe angleze është përparësi
<b>Aftësitë:</b>	Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi Njohuri e avancuar e MS Office (sidomos Word dhe Excel) Aftësi të prioritizimit të punëve në situata presioni

### AFATI DHE MËNYRA E KONKURRIMIT:

Konkursi është i hapur deri më **14 maj 2025 23:59 (CET)**, Puna praktike është me pagesë.

Konkurrimi bëhet vetëm përmes postës elektronike (e-mail) në: [recruitment@trusti.org](mailto:recruitment@trusti.org), duke vendosur si titull "Konkursi për praktikantë 2026", duke bashkëngjitur dokumentet në vijim (në formatin PDF):

**1)** Jetëshkrimin (CV-në); **2)** Letrën motivuese; **3)** Diplomën (e skanuar) e kualifikimit më të lartë arsimor. (Kandidatët që janë në vitin e fundit të studimeve, paraqesin certifikatën e notave të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë).

### VËMENDJE!:

**1)** Kandidatët mund t'i nënshtrohen një testi preliminar. Pas testit mund të përzgjidhen kandidatët për intervistë. Vetëm kandidatët e zgjedhur për intervistë do të njoftohen pas testimit.

**2)** Aplikacionet pa bashkëngjitur "Dokumentet për aplikim" (pikat e obligueshme 1 deri 3) si dhe ato të dorëzuara pas afatit, NUK do të shqyrtohen. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit do të kontaktohen.